



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 105/3 Prot.

Tiranë, më 25.03.2024

V E N D I M

Nr. 25, datë 25.03.2024

Mbi përfundimin e procesit të inspektimit të thelluar, në lidhje me vlerësimin e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil, në zhvillimin e procedurave gjatë aplikimit të institutit të disiplinës, të kryer në institucionin e Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit.

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në pikën 1, të nenit 11, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit, të ndryshuar, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në përfundim të procesit të inspektimit të nisur me Urdhrin nr. 22 (nr.105 prot.), datë 30.1.2024, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VËREJ SE:

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1 dhe nenin 14, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, si dhe neneve 2 dhe 14, germa a), neneve 16 dhe 19, pika 1 dhe 21 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, të miratuar me Vendimin nr.17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, i ndryshuar, si dhe nisur nga informacionet që kanë ardhur nga nëpunësit civilë të institucionit për kryerjen e veprimeve administrative në kundërshtim me ligjin, nga ana e subjekteve të ngarkuara me detyra specifike të administrimit të shërbimit civil, me urdhrin nr. 22 (nr.105 prot.), datë 30.1.2024, “Për kryerjen e inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, në zhvillimin e procedurave gjatë aplikimit të institutit të disiplinës, në institucionin e Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit”, ka vendosur fillimin e inspektimit për vlerësimin e ligjshmërisë së veprimeve të kryera gjatë zhvillimit

të procedurave disiplinore, në institucionin e Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunitetit.

Gjatë këtij procesi inspektimi, grupi i punës verifikoi procedurat disiplinore të zhvilluara në ngarkim të nëpunësve civilë të institucionit, për periudhën objekt inspektimi, nga rezultoi se, në total për këtë periudhë janë zhvilluar 4 procedura disiplinore, në përfundim të së cilave janë dhënë 3 masa disiplinore.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar, rezultoi se, sipas shkeljeve të kryera nga nëpunësit, në 3 raste ato janë klasifikuar si “shkelje të lehta” dhe është propozuar dhënia e masës disiplinore “Vërejtje”, të parashikuar në germën a), neni 58, i ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, në ngarkim të nëpunësve të evidentuar më poshtë:

1. *****, emëruar në pozicionin “Nëndrejtor Ekzekutiv/Drejtor Drejtorie,” në Drejtorinë e Arkivës dhe Bibliotekës, me aktin nr.59/1 prot., datë 22.7.2021.
2. *****, emëruar në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Edukimit dhe Informimit Publik”, me aktin nr.199/1 prot., datë 13.12.2022.
3. *****, emëruar në pozicionin “Drejtor Drejtorie”, në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, me aktin nr. 35/11 prot., datë 25.6.2021.
4. Ndërsa, në 1 (një) rast shkelja është klasifikuar si “shkelje shumë e rëndë” dhe është propozuar masa disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, e parashikuar në germën ç), të nenit 58, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, bëhet fjalë për nëpunësin *****, emëruar në pozicionin “Specialist/Jurist” pranë ISKK, larguar nga shërbimi civil me vendimin nr. 1 (nr.215 prot.), datë 5.7.2019, të Komisionit të Disiplinës.

Referuar përmbajtjes së dokumentacionit të administruar në dosjen e ecurisë disiplinore, për rastet e lartpërmendura, në vijim të materialit parashtrihen rrethanat konkrete, si dhe procedura e ndjekur në secilin rast.

- ❖ Verifikimi i procedurës së ndjekur në dhënien e masës disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, në ngarkim të nëpunësit *****.

Nga analiza e materialeve shkresore të administruara për këtë rast, pas shqyrtimit të dokumentacionit që pasqyron veprimet administrative që janë kryer gjatë procedimit disiplinor në ngarkim të tij, që nga momenti i konstatimit të shkeljes disiplinore deri në marrjen e vendimit përfundimtar nga organi disiplinor, rezulton se:

Me vendimin nr. 1 (nr.215 prot.), datë 5.7.2019, Komisioni i Disiplinës ka dhënë masën disiplinore “Largim nga shërbimi civil”, për nëpunësin *****, e parashikuar në germën ç), të nenit 58, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Në vijim të hetimit të këtij rasti, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, referuar dokumentacionit të administruar, u njoh me faktin se, për kundërshtimin e këtij akti, nëpunësi ka ngritur padi në Gjykatën Administrative, Tiranë.

Me tej, anë të vendimit nr. 3706 (80-2019-3749), datë 29.10.2019, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadi së paditësit ***** si të pabazuar në prova dhe në ligj.

Ky vendim është ankimuar nga paditësi në Gjykatën Administrative të Apelit dhe në sekretarinë gjyqësore të kësaj gjykate, në datën 27.12.2023 është paraqitur një kërkesë me shkrim nga ana e tij, me anë të së cilës është kërkuar përshpejtimi i gjykimit çështjes në fjalë, duke parashtruar edhe arsyet përkatëse, kërkesë e cila është pranuar nga gjykata me anë të vendimit nr. 46 prot., datë 26.01.2024 “Për përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes”.

Në këto rrethana, referuar paragrafit 3, të nenit 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, “Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”, i cili sanksionon se, asnjë institucion tjetër nuk ka të drejtë të pranojë për shqyrtim një mosmarrëveshje civile që është duke u gjykuar nga gjykata, Komisioneri vlerëson se, hetimi administrativ i këtij rasti duhet të ndërpritet, rasti në fjalë duhet të zgjidhet midis palëve sipas vendimit përfundimtar që do të jepet nga gjykata. Ky rast do të jetë në vëmendjen e Komisionerit për tu njohur me vlerësimin që i ka bërë gjykata respektimit të dispozitave të ligjit nga ana e organit të disiplinës.

❖ Verifikimi i procedurës së ndjekur në dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, në ngarkim të nëpunëses *****.

Në mbështetje të dokumentacionit të administruar, konstatohet se, nëpërmjet aktit nr. 1, (nr. 244/5 prot.), datë 28.12.2023, “Shkelje e rregullave të etikës, për dhënien e lejes pa të drejtë page punonjësit, pa miratimin e Drejtorit Ekzekutiv”, është dhënë masa disiplinore “Vërejtje” për punonjësen *****. Referuar materialeve shkresore të administruara në lidhje me këtë procedim disiplinor rezulton se, shkak për fillimin e ecurisë ka qënë fakti që, në datën 1.12.2023, Drejtoresha e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse ka dërguar për firmë listëprezencën e muajit nëntor, pranë Drejtorit Ekzekutiv, në të cilën rezultonte të mos kishte asnjë mungesë nga ana e punonjësve. Ky i fundit, nuk e ka nënshkruar dhe i ka kërkuar ta përsërisë listëprezencën, për ta plotësuar atë, pasi kishte evidentuar parregullsi në këtë akt, të cilat konsistojnë në faktin se nuk është pasqyruar saktë situata e prezencës në punë.

Pas këtij veprimi, Drejtori Ekzekutiv është larguar jashtë vendit, duke i deleguar detyrat nëpunëses ***** në rolin e Zv/Drejtorit Ekzekutiv. Në datën 5.12.2023, nëpunësja i ka dërguar një e-mail Drejtorit Ekzekutiv, ku ka kërkuar miratimin e tij për të firmosur listëprezencat.

Më tej, Drejtori Ekzekutiv, i është përgjigjur dhe ka sqaruar nëpunësen *****, se, listëprezenca është kthyer pasi ka evidentuar parregullsi në pasqyrimin e prezencës së punonjësve në institucion, gjithashtu ka vërejtur se, punonjësja *****, i janë hequr dy ditë pune, pasi ka munguar pa të drejtë page, me leje të eprores së saj, *****, fakt për të cilin, kjo e fundit nuk e ka njoftuar Drejtorin Ekzekutiv.

Për këtë arsye, me shkresën nr. 244/1 prot., datë 18.12.2023, me lëndë “Njoftim për nisjen e procedimit disiplinor”, të Drejtorit Ekzekutiv, nëpunësja ***** është njoftuar se, ndaj saj ka nisur ecuria disiplinore, me motivacionin: shkelje e rregullave të etikës, për dhënien e lejes pa të drejtë page punonjësit, pa miratimin e Drejtorit Ekzekutiv. Në shkresë është caktuar edhe seanca dëgjimore, për t’u zhvilluar në datën 26.12.2023, ora 10:00, në zyrën e Drejtorit Ekzekutiv, duke i dhënë kohë për paraqitjen e parashtrimeve me shkrim nëpunëses, deri në datën 23.12.2023.

Përpara zhvillimit të seancës degjimore, nëpunësja *****, me shkresat nr.244/2 prot., datë 26.12.2023 dhe nr.244/3 prot., datë 26.12.2023, me lëndë: “Sqarime për çështjen “Vendim për nisjen e procedimit disiplinor ndaj Drejtoreshës së Arkivit dhe Bibliotekës të ISKK”, nr. 244 prot., datë 18.12.2023 dhe kërkesë për seancën e datës 26 dhjetor 2023 mbi këtë çështje”, ka sqaruar rrethanat e çështjes pranë eprorit, si dhe ka kundërshtuar procesin, por argumentat e paraqitura nuk janë marrë parasysh nga organi disiplinor.

Me anë të procesverbalit nr. 244/4 prot., datë 26.12.2023, në të cilin është dokumentuar seanca dëgjimore, provohet se, nëpunësja në ngarkim të së cilës ka nisur ecuria disiplinore ka qenë e pranishme në takim dhe është mbrojtur nëpërmjet përfaqësuesit ligjor, i cili ka paraqitur pretendimet e saj në seancë.

Në përfundim të procedurës disiplinore, të nisur në ngarkim të nëpunëses *****, me vendimin nr. 1, (nr. 244/5 prot.), datë 28.12.2023, të Drejtorit Ekzekutiv, “Shkelje e rregullave të etikës, për dhënien e lejes pa të drejtë page punonjësit, pa miratimin e Drejtorit Ekzekutiv”, ndaj saj është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, e parashikuar në germën a), të nenit 58, të ligjit nr.152/2013, i ndryshuar, e klasifikuar si shkelje e lehtë.

❖ Verifikimi procedurës së ndjekur në dhënien e masës disiplinore “Vërejtje”, në ngarkim të nëpunësit *****.

Nëpërmjet aktit nr. 1, (nr.248/4 prot.), datë 28.12.2023, është dhënë masa disiplinore “Shkelje e rregullave të etikës, në mënyrë të përsëritur” në ngarkim të nëpunësit *****. Nga përmbajtja e materialeve shkresore të administruara për këtë nëpunës rezulton se, bazuar në planin vjetor të punës së institucionit, është planifikuar organizimi i konferencës shkencore të ISKK-së. Për mbulimin mediatik dhe publikimin e saj në rrjetet sociale, përmes e-mailit të datës 14.11.2023, është ngarkuar nëpunësi në procedim. Sipas

qëndrimin të Drejtorit Ekzekutiv, nëpunësi nuk e ka realizuar këtë detyrë. Gjithashtu, ky nëpunës ka dorëzuar raportin vjetor të sektorit të tij, në shkelje të afateve, të vendosura nga titullari.

Për këto arsye, me shkresën nr. 248/1 prot., datë 20.12.2023, me lëndë “*Njoftim për nisjen e procedimit disiplinor*”, të Drejtorit Ekzekutiv, nëpunësi ***** është njoftuar se, ndaj tij ka nisur ecuria disiplinore, me motivacionin: “*mosparaqitje në punë në orar, mospërmbushje e detyrës, mosrespektim i urdhërit të Drejtorit Ekzekutiv*”. Në shkresë është caktuar edhe seanca dëgjimore, për t’u zhvilluar në datën 27.12.2023, ora 10:00, në zyrën e Drejtorit Ekzekutiv, duke i dhënë kohë për paraqitjen e parashtrimeve me shkrim nëpunësit, deri në datën 26.12.2023.

Më tej, me shkresën nr. 248/2 prot., datë 27.12.2023 me lëndë: “*Dërgimi i prapësimeve dhe observacioneve për shkresën nr. 248 prot., datë 20.12.2023*”, “*Vendim për nisjen e procedimit disiplinor ndaj Përgjegjësit të Sektorit të Edukimit dhe Informimit Publik në ISKK*”, nëpunësi në procedim, ka sqaruar rrethanat e çështjes, si dhe ka kundërshtuar procesin pranë eprorit të tij, me argumenta të cilat nuk janë marrë parasysh nga organi i disiplinës.

Me anë të procesverbalit nr. 248/3 prot., datë 27.12.2023, në të cilin është dokumentuar seanca dëgjimore, provohet se, nëpunësi në ngarkim të së cilit ka nisur ecuria disiplinore ka qenë i pranishëm dhe ka paraqitur pretendimet e tij në seancë.

Në përfundim të procedurës disiplinore, të nisur në ngarkim të nëpunësit ***** , me vendimin nr. 1, (nr.248/4 prot.), datë 28.12.2023, “*Shkelje e rregullave të etikës, në mënyrë të përsëritur*”, të Drejtorit Ekzekutiv, ndaj tij është dhënë masa disiplinore “*Vërejtje*”, e parashikuar në germën a), të nenit 58, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar. Masa i është njoftuar nëpunësit me anë të vendimit nr. 248/5 prot., datë 28.12.2023, me lëndë “*Njoftim vendimi për dhënie mase disiplinore, ndaj ******”.

❖ Verifikimi i procedurës së ndjekur në dhënien e masës disiplinore “*Vërejtje*”, në ngarkim të nëpunëses *****.

Nga përmbajtja e materialeve shkresore të administruara në dosjen e procedimit disiplinor për nëpunësen ***** , të cilat janë pasqyruar edhe në vendimin nr. 234 prot., datë 01.12.2023, “*Vendim për nisjen e procedimit disiplinor*”, rezulton se, në datën 21.11.2023, Drejtori Ekzekutiv, i ka kërkuar Specialistes së IT-së, ta informonte për prezencën e punonjësve në punë, duke e verifikuar atë nëpërmjet kamerave të institucionit. Në lidhje me këtë kërkesë, nëpunësja në procedim disiplinor, pretendohet se, e ka ndaluar punonjësën për të verifikuar të dhënat, duke anuluar kështu urdhërin e Drejtorit Ekzekutiv.

Gjithashtu, në datën 8.11.2023, Drejtori Ekzekutiv, i ka kërkuar përsëri nëpunëses *****; të shprehet lidhur me një ankesë të bërë nga një punonjëse tjetër, me detyrë “Specialiste e Burimeve Njerëzore”, detyrë të cilën punonjësja nuk e ka kryer.

Për këto arsye, me shkresën nr. 234/1 prot., datë 1.12.2023 “Njoftim për nisjen e procedimit disiplinor”, të Drejtorit Ekzekutiv, nëpunësja ***** është njoftuar se, ndaj saj ka nisur ecuria disiplinore, me motivacionin: “Anulim i paligjshëm i urdhërit të Drejtorit Ekzekutiv”. Në shkresë është caktuar edhe seanca dëgjimore, për t’u zhvilluar në datën 12.12.2023, në mjediset e institucionit, duke i dhënë kohë për paraqitjen e parashtrimeve me shkrim nëpunëses, deri në datën 7.12.2023.

Më tej, me shkresën nr.234/2 prot., datë 7.12.2023, me lëndë: “Dërgimi i prapësimeve dhe observacioneve për shkresën nr. 234 prot., datë 01.12.2023”, “Vendim për nisjen e procedimit disiplinor ndaj Drejtoreshës së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në ISKK”, nëpunësja ka sqaruar rrethanat e çështjes, si dhe ka kundërshtuar procesin, argumenta të cilat janë marrë parasysh nga organi i disiplinës dhe sipas procesverbalit nr. 234/3 prot., datë 12.12.2023, në të cilin është dokumentuar seanca dëgjimore, rezulton se, eprori direkt, ka vendosur përfundimin e procedimit disiplinor në ngarkim të kësaj nëpunësjë, bazuar në nenin 18, germa a), të VKM-së nr. 115, datë 5.3.2014 dhe në seksionin A, germa a), të udhëzimit nr.1, datë 2.4.2014, të DAP, me arsyetimin se, ai ka pasur paqartësi në lidhje me kuadrin ligjor për administrimin e sistemit të kamerave, ç’ka është sqaruar dhe nuk përbën shkak për vijimin e ecurisë disiplinore.

- ✓ Sa i përket aspektit procedural të ndjekur gjatë zhvillimit të procedurave disiplinore, në përfundim të së cilave nëpunësve ***** dhe *****; i është dhënë masa disiplinore “Vërejtje”, konstatohet se:

Referuar analizës së akteve të administruar gjatë procedurës disiplinore të ndjekur në ngarkim të nëpunësve ***** dhe *****; konstatohet se, shkeljet e kryera nga nëpunësit klasifikohen si shkelje të lehta në mbështetje të germës b), pika 4, e nenit 57, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, e si rrjedhim, organi disiplinor kompetent për shqyrtimin e tyre, në këtë rast është eprori direkt.

- ✓ Në këtë moment duhet të sqarojmë rolin e eprorit direkt për këta dy nëpunës, ç’ka është një aspekt ku është evidentuar paqartësi edhe në raste të tjera nga ana e punonjësve të institucionit, për të cilat janë paraqitur informacione edhe pranë Komisionerit, në bazë të organikës së Institutit të Studimeve për Krime dhe Pasojat e Komunitetit, miratuar me Vendimin nr. 117, datë 2.11.2023 “Për disa ndryshime në vendimin e Kuvendit nr.11/2021 “Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës së institutit të studimeve për krimet dhe pasojat e komunizmit në Shqipëri”, i ndryshuar, si dhe Rregullores së Brendshme të institucionit, miratuar me vendimin nr.

7/2018 (5/3 prot.) datë 09.05.2018, “Për miratimin e Rregullores së Brëndshme dhe të Rregullores së Botimeve të ISKK”, vlerësojmë se, për nëpunësen ******, me detyrë “Nëndrejtor Ekzekutiv/Drejtor i Drejtorisë së Arkivit dhe Bibliotekës”, në rolin e eprorit direkt është Drejtori Ekzekutiv, i institucionit. Në këtë përfundim arrihet edhe duke analizuar përshkrimin e punës për këtë pozicion pune.

Ndërsa, për pozicionin “Përgjegjës Sektori në Sektorin e Edukimit dhe Informimit Publik”, ku është i punësuar nëpunësi ******, eprori direkt është nëpunësi i cili mban pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Studimeve”, e duke qënë se ky pozicion është vakant, në rolin e eprorit direkt do të jetë nëpunësi pasardhës në linjë hierarkie, që rezulton të jetë sërish Drejtori Ekzekutiv, i institucionit.

Më tej, sa i takon respektimit të të drejtave të nëpunësit civil, në vijim të procedurës disiplinore, në zbatim të pikës 13, germa b) dhe c), të Vendimit nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”, rezulton se aktet për fillimin e ecurisë disiplinore, me shkresën përkatëse, i janë komunikuar nëpunësve në procedim disiplinor, duke respektuar kërkesat procedurale që sigurojnë zbatimin e së drejtës për t’u mbrojtur duke paraqitur sqarimet përkatëse.

Në këto kushte, rezulton e provuar se, nëpunësit në fjalë, kanë pasur mundësinë për t’u dëgjuar, e për t’u mbrojtur duke paraqitur e kërkuar prova në lidhje me shkeljen e pretenduar, ç’ka përbën edhe realizimin në përmbajtje të procedurës disiplinore. Janë respektuar të gjitha afatet e përcaktuara në seksionin “B”, “Detyrat e Eprorit direkt gjatë procedimit disiplinor”, të Udhëzimit nr. 1, datë 2.4.2014, të Departamentit të Administratës Publike “Për elementët kryesorë proceduralë dhe material të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”, në të cilën shprehimisht thuhet se:

“Për rastet e klasifikuara si shkelje të lehta, eprori direkt fillon pa vonesë procedimin disiplinor, duke njoftuar menjëherë nëpunësin civil për fillimin e ecurisë disiplinore në ngarkim të tij, jo më vonë se 2 ditë punë nga marrja e vendimit.”

Procedura disiplinore në përmbajtje ka për qëllim që të sigurojë respektimin e të drejtës së nëpunësit që të marrë dijeni për fillimin e një ecurie apo procedimi disiplinor, njohjen e tij me shkeljen e pretenduar, dhënien e mundësisë për tu dëgjuar dhe shprehjen e mendimit të tij, mundësinë e mbrojtjes, të drejtën për t’u asistuar nga një avokat apo një përfaqësues ligjor, duke u dëgjuar dhe paraqitur prova, hapa të cilat në këtë rast vlerësohet se janë respektuar e kryer nga ana e institucionit, duke i garantuar nëpunësve të drejtat që përcaktohen në pikën 7, të nenit 59, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.

Konstatohet se, data e vendosur për të shqyrtuar shkeljet e pretenduara, në të dy rastet, ka qënë në respektim të afateve të përcaktuara në germën g), të udhëzimit nr. 1, datë 2.4.2014, të Departamentit të Administratës Publike, jo më shpejt se 4 (katër) ditë dhe jo më vonë se 16 (gjashtëmbëdhjetë) ditë nga marrja e njoftimit nga nëpunësit, për fillimin e ecurisë disiplinore ndaj tyre. Seancat e shqyrtimit të çështjeve disiplinore janë zhvilluar rregullisht, me dakordësinë e palëve, *(kjo provohet me procesverbalet e zhvillimit të seancave dëgjimore, të administruara për secilin proces disiplinor).*

Si konkluzion, në përmbledhje të argumentave dhe dokumentacionit të evidentuar në përmbajtje të materialit, vlerësojmë se, procedura disiplinore për të dyja rastet, është kryer në respektim të të drejtave të nëpunësit civil, duke i siguruar nëpunësve të lartpërmendur të drejtën e mbrojtjes, dëgjimit të pretendimeve të tyre, mundësisë së paraqitjes apo kërkitimit të provave dhe ka përfunduar me nxjerrjen e vendimit përkatës nga eprori direkt.

Sa i përket ndërprerjes së ecurisë disiplinore, për rastin e nëpunëses ***** , rezulton se procesi është kryer në përputhje me kërkesat e ligjit, sipas përcaktimeve të pikës 17 të VKM-së nr. 115, datë 5.3.2014 *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”* dhe Kreut I, gërmës “A”, pikës “3”, të Udhëzimit nr. 01, datë 02.04.2023, *“Për elementët kryesorë proceduralë dhe materialë të ecurisë dhe shqyrtimit të shkeljeve disiplinore”*, të DAP.

Për këtë arsye, duke qënë se gjatë procesit të inspektimit nuk u konstatuan veprime në kundërshtim me ligjin për nëpunësin civil, ky proces inspektimi do të përmbillet pa vendim paralajmërimi.

Për këtë arsye:

Në mbështetje të kompetencës së përcaktuar në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, të nenit 36, të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, *“Kodi i Procedurës Civile i Republikës së Shqipërisë”*, të nenit 90, pika 2, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i RSH”* si dhe në mbështetje të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të ndryshuar,

VENDOSA:

1. Të përfundojë hetimi administrativ i nisur me urdhrin e inspektimit nr. 22 (nr.105 prot.), datë 30.1.2024, *“Për kryerjen e inspektimit të thelluar, në lidhje me zbatimin e legjislacionit të shërbimit civil, në zhvillimin e procedurave gjatë aplikimit të institutit të disiplinës, në institucionin e Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të*

Komunizmit”, të Komisionerit, pasi gjatë këtij procesi nuk u konstatuan parregullësi në zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.

2. Të njoftohet për këtë vendim institucioni i Institutit të Studimit të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera Strakosha

